

TË ARDHURA QË LULËZOJNË

Investoni në fondin që vë
në lëvizje kursimet tuaja

Raport Muaji Janar 2023

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	01 Mars 2012
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	5,000
Shuma minimale pasuese	1,000

Komisionet dhe Tarifat

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	0%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Referojuni prospektit te fondit
Komisione/tarifa e vazhdueshme	1.27% per vitin 2022
Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta	Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizojë kthimin nga investimi, duke synuar në të njëjtën kohë ruajtjen e kapitalit të investitorit dhe sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

Asetet e fondit janë të investuara në bono thesari dhe obligacione të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.


Shifra e tarifës së vazhdueshme 1.27% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Prestigj është në kategorinë e dytë të Profilit të Rrezikut dhe Perfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.


Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 31.01.2023

Vlera Neto e Aseteve	25,409,597,857
Numri i investitoreve	21,440
Çmimi i Kuotes	1,533.5015
*Kthimi vjetor neto nga investimi (31.01.2022 – 31.01.2023)	-2.84%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 31 Janar 2023



Në kuadër të politikës së investimit të fondit Prestigj, investimet do të kryhen kryesisht në bono dhe obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar apo transaksioneve në tregun sekondar. Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy herë në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një herë në muaj; 7 dhe 10 vjeçare janë me të rralla, afërsisht një herë në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një herë në 2 muaj për secilin maturitet.

Instrumenti

Marreveshje të Anasjellta të Riblerjes – Rev Repo
 Depozita & Llogari rrjedhese
 Bono Thesari
 Obligacione Thesari

Ne % te Aseteve te Fondit

6.38%
 11.63%
 9.22%
 72.78%

Strategjia e investimeve është e fokusuar në tituj të Qeverisë Shqiptare, por përveç këtyre investimeve, Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 25.4 miliardë në datë 31 Janar 2023.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Janar

Banka e Shqipërisë ka marr vendimin për të mbajtur normën bazë të interesit të pandryshuar në nivelin 2.75%. Politika monetare e ndjekur kete periudhe ka nisur te kete efektet e saj, duke bere qe inflacioni të shënoje rënie gjatë muajve te fundit.



Normat e interesit te bonove dhe obligacioneve te Qeverise Shqiptare ne te cilat fondi Prestigj investon kane ndryshuar trend duke rene ne fillim te vitit 2023. Kjo rene e normave pritet te vazhdoje gjate pjeses se pare te vitit dhe me pas te stabilizohen gjate pjeses se dyte. Asetet e Fondit Prestigj jane te investuara vetem ne bono dhe obligacione te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe per kete arsye fondi eshte i ekspozuar ndaj ndryshimeve ne normat e interesit te ketyre titujve, ndaj renia e normave te interesit ka patur nje ndikim pozitiv ne portofolin e investimeve dhe si rrjedhoje cmimi i kuotes se fondit shenoi nje rritje me +1.53% gjate muajit Janar.

Pergjate muajit Janar ne tregun vendas, normat e interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare paten nje trend renes, me perjashtim te obligacionit 10-vjeçar i cili ishte obligacioni i fundit qe u korrektova me rritjen e normave.

Yieldi i Bonos se Thesarit 12-mujore rezultoi ne 4.859% duke rene me 0.61% ne krahasim me ankandin e muajit Dhjetor. Yieldi i Bonove te Thesarit 3 dhe 6 mujore u ulen perkatesisht me 0.10% dhe 0.26% ne krahasim me ankandet paraardhese.

Per sa i perket obligacioneve, ankandi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi ne 5.80%, duke rene me 0.44% krahasuar me ankandin paraardhes. Ankandi i obligacionit reference 5-vjeçar rezultoi ne 6.073%, duke rene me 1.61% krahasuar me ankandin e fundit. Ankandi i obligacionit 10-vjeçar rezultoi ne 7.60%, duke u rritur me 0.12% krahasuar me ankandin paraardhes.


Grafiket me poshte japin nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te thesarit te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Janar 2022 – Janar 2023. Per obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yield-et fikse te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Janar.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri ne 31 Janar 2023

Kthimi vjetor neto per periudhen 31 Janar 2022 – 31 Janar 2023 eshte **-2.84%.** Çmimi i kuotes se fondit Prestigj ne muajin Janar eshte rritur ndjeshem me **+1.53%** si rrjedhoje e renies se normave te interesit te bonove dhe obligacioneve te emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet e normave te interesit te titujve te borxhit te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Keshtu kur normat e interesit ne treg rriten, vlera e titujve te portofolit ulet dhe per rrjedhoje ulet dhe norma e kthimit per periudhen e kaluar. E kunderta ndodh kur normat e interesit ulen. Per pasoje, çmimi i kuotes mund te jete i luhatshem. Luhatsmeria eshte pjese e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi i saj eshte i pamundur, keshtu çmimi i kuotes mund edhe te bjere, jo vetem te rritet.



Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Prestigj per çdo vit



Investitorët e fondit Prestigj dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfutur nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter. Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga konflikti gjeopolitik dhe rritja e inflacionit, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithe shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha., në website www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.